



PROCESVERBALI

Mbledhja e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) në Rahovec, e mbajtur më 08.09.2021 me fillim në ora 15.30. Mbledhjen e kryesoi Kryetari Komunës **Smajl Latifi**: Kuorum për mbajtjen e mbledhjes kemi.

Kryetari- Më lejoni t'i përshëndes të gjithë të gjithë anëtarët e KKSB, nënkryetarin e komunës, Fatmir Iska, drejtorët e drejtorive, togerin e stacionit të policisë në Rahovecit z. Bekim Vuçitërna, Përfaqësues të Ushtrisë së Kosovës prezent këtu, përfaqësuesit e mediave dhe gjithë të pranishmit e tjerë që janë prezent në sallë. Është mbledhja e pestë e rregullt e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi. Përpara e keni një rend dite i cili buron nga plani vjetor i punës për vitin 2021 i cili është aprovuar edhe në Kuvendin e Komunës.. Për këtë mbledhje propozoj këtë:

Rend Dite

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Informatë rreth situatës së krijuar nga pandemia Covid – 19;
3. Vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së sigurisë në territorin e komunës së Rahovecit;
 - Prishja e qetësisë publike nga lokalet e natës dhe personat e papërgjegjshëm
 - Trajtimi i mbrojtjes së pyjeve nga dëmtuesit ilegalë,
 - Vetëdijesimi nga minat dhe mjeteve tjera të pa shpërthyer nga lufta,
 - Identifikimi i hapësirave për qasjen e personave me nevoja të veçanta,
 - Monitorimi dhe raportimi mbi nivelin e sigurisë në shkolla dhe zbatimin e planit për siguri në shkolla,
 - Siguria në trafik.
 - Raportimi dhe parandalimi i dhunës në familje
 - Rreth veprimeve dhe masave për luftimin e shkelësve të ligjit në komunën e Rahovecit,
4. Të Ndryshme.

Kryetari - A ka dikush të shtoj diçka sa i përket rendit të ditës, nëse jo atëherë e qes në votim. Konstatohet se në mënyrë unanime është aprovuar rendi i ditës. Kalojmë në pikën e radhës:

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar:

A ka dikush të shtoj diçka sa i përket procesverbalit nga mbledhja e kaluar, nëse jo atëherë e qes në votim: Konstatohet se në mënyrë unanime është aprovuar procesverbali nga mbledhja e kaluar. Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës:

2. Informatë rreth situatës së krijuar nga pandemia Covid – 19.

Kryetari – Do i jap disa informata sa i përket situatës me Covid – 19 në komunën e Rahovecit. Ne një kohë kemi qenë me zero raste, kemi qenë komuna e parë që kemi pasur zero raste, por tani kemi rreth 600 raste si komunë, ne kemi raporte për çdo ditë sa i përket rasteve me Covid – 19, pra siç e cek kemi një rritje të rasteve me Covid -19 si komunë. Ne jemi duke vazhduar me teste rapide 9 (shpejta) si QKMF ashtu edhe në

QMF-në e Krushës së Madhe dhe Ratkoc, ky është një lajm i mirë sepse qytetarët e kanë mundësinë e shërbimit më afër në mënyrë që të dinë se a janë të infektuar apo jo. Poashtu është duke vazhduar procesi i vaksinimit të qytetarëve, deri në ditën e djeshme i kemi rreth 29660 qytetarë të vaksinuar të komunës sonë. Ne kemi insistuar që të hapen qendrat e reja të vaksinimit në Krushë të Madhe dhe Ratkoc, por nuk kemi marrë përgjigje pozitive nga Ministria e Shëndetësisë, na kanë dhënë disa arsyetime pse nuk kemi të drejtë t'i hapim qendrat e tjera të vaksinimit. Ne poashtu kemi kërkuar që vaksinimi të vazhdojë edhe të shtunave dhe të dielave, por me shumë mundim na kanë dhënë leje për ditën e shtunë, kurse e diela duhet të jetë ditë pushimi, ajo që dua të them është se ecuria e vaksinimit nuk është përgjegjësi vetëm e komunave sepse Master Plani është nga Ministria e Shëndetësisë, dozat e vaksinës dhe shiringat janë poashtu nga ministria, pastaj shtimi i ekipeve poashtu varet nga ta se sa na lejojnë, poashtu edhe ecuria ose numri i lejuar për një ditë varet nga Ministria e Shëndetësisë etj. Unë si kryetar i komunës i kam bërë thirrje qytetarëve tanë që të vaksinohen me vaksinë anti Covid - 19, poashtu kjo thirrje duhet të del besoj edhe nga ky këshill, besoj se duhet të bëhet një fushatë vetëdijesuese të qytetarët në mënyrë që mos të kenë dyshime në llojet e vaksinave sepse të gjitha vaksinat që janë në Kosovës janë të licencuara dhe kanë të njëjtin efekt. Ne si komunë jemi duke u përpjekur që të zbatojmë masat anti Covid - 19, jeni duke parë që tek qytetarët e komunës sonë ka një ndjenjë më të lartë të përgjegjësisë për sa i takon zbatimit të masave, janë duke u përdorur më shumë maska, mbahet më shumë distanca, nuk ka aktivitete publike, dasma dhe aktivitetet tjera pas orës 21:30, poashtu edhe ora policore është duke u zbatuar edhe pse kam një mendim tjetër sa i përket orës policore, por ne i respektojmë vendimet e Qeverisë së Republikës së Kosovës. I ftojme nga ky këshill qytetarët tanë që të vazhdojnë që të respektojnë masat deri në vendimin tjetër të marrë nga qeveria, shpresojmë që nga data 13 shtator do të kemi lajme më pozitive sa i përket masave.

Konkluzë: Në komunën e Rahovecit ka më shumë respektim të masave se sa që ka pasur në të kaluarën, por, në anën tjetër kemi një gjendje më të vështirë sa i përket bizneseve sepse deri më tani nuk kemi ndonjë mbështetje për bizneset, bujqit ose fermerët nga ana e qeverisë qendrore. Ne i shprehim ngushëllime familjarëve të cilët i kanë humbur më të shtrenjtët e tyre nga Covid - 19, ky numër nuk është fare i vogël.

Nysret Abazibra – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, desha të ndaj një informatë shtesë sepse besoj se është e nevojshme, e përmendet çështjen e ndikimit të Covid - 19 në vdekjet, muaji i kaluar ishte një muaj që asnjëherë në historinë e Komunës së Rahovecit nuk ka ndodhur të ketë aq shumë varrime, në kulmin e pandemisë kemi pasur 65 raste, kurse muajin e kaluar kemi pasur 72 raste të vdekjeve, ka ky numër 20 janë të regjistruar me Covid - 19. Por edhe unë sikurse ju kryetar po e ngris një shqetësim sepse kemi raste të vdekjeve që nuk po faktohen me dokumente që janë raste të vdekjeve me covid - 19, më herët ka qenë rregull se çdo kush që ka qenë me Covid - 19, ka qenë nën përcjelljen e policisë dhe varrimi është bërë me masa të veçanta, tani kemi shumë raste që njerëzit me covid po vdesin nëpër shtëpitë e tyre dhe varrimi po kryhet pa kurrfarë mbikëqyrje.

Ramë Berisha – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, sa i përket pandemisë, qeveria komunale së bashku me ministrinë kanë qenë gjithmonë aktive dhe në përballje me pandeminë, ku i kanë bërë thirrje qytetarëve që të kenë kujdes dhe të mbrohen, tani kemi edhe vaksinë dhe këto vaksinë janë edhe në Kosovë, prandaj ne si qytetar duhet të i marrim ato në mënyrë që të mbrohemi, prandaj e përgëzoj kryetarin për punën e bërë sa i përket mbrojtjes së qytetarëve nga kjo sëmundje e padukshme.

Kryetari – Pajtohem plotësisht me parafolësit, posaçërisht me atë që e tha hoxha i nderuar, më parë ka pasur një rend dhe ka pasur informacione të sakta se kush është me covid - 19, kjo situatë më nuk është e njëjtë, tani ne nuk kemi informacione të sakta ose zyrtare se kush është me covid - 19, ne marrim informacione në rrethana tjera dhe burime tjera. Ju faleminderit, nëse nuk ka askush diçka tjetër të shtoj sa i përket kësaj pike, kalojmë në pikën e radhës:

3. Vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së sigurisë në territorin e Komunës së Rahovecit. Sipas gjitha informatave dhe burimeve që i kemi, gjendja në komunën e Rahovecit vazhdon të jetë e qetë dhe stabile, me disa incidente të vogla. Sa i përket problemeve ndëretnike nuk kemi pasur, ndonjë rast të raportuar sa i përket problemeve ndëretnike. Por kjo nuk do të thotë që ne në komunën tonë nuk kemi angazhime, ngjarje, delikuenca, incidente, kundërvajtje, vepra penale të vogla, por, për të gjitha këto sigurisht që do na thotë pak më shumë togeri i policisë z. Bekim Vuçitërna.

Bekim Vuçitërna - Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, Raportimi mbi aktivitetet të stacionit policor në Rahovec për periudhën 3 mujore, nga data 09.06.2021 deri më ditën e sotit. Situata e sigurisë në përgjithësi në komunën tonë mbetet e qetë dhe stabile, policia e Kosovës në kuadër të punës në vazhdimësi angazhohet me detyra konkrete dhe me aktivitetet të shumta policore, ku në vazhdimësi përkujdeset që siguria e përgjithshme të jetë në një nivel të kënaqshëm për të gjithë qytetarët në mënyrë që ata të mundën të jetojnë të qetë dhe në një ambient të sigurt. Kurse sa i përket situatës së krijuar nga pandemia Covid – 19, policia e Kosovës është duke u angazhuar me kapacitete të plota si në personal ashtu edhe me logjistik, duke punuar me orare të zgjatura deri në 12 orë, poashtu stacioni i policisë në Rahovec në disa raste edhe asistohet nga njësitet e specializuara në kuadër të drejtorisë rajonale të policisë në Gjakovë. Poashtu patrullat tona vazhdojnë të asistojnë inspektoratin sanitar të AVUKUT dhe atyre komunal, kjo gjithmonë vije në bazë të kërkesave dhe nevojave në teren. Në kuadër të planit operativ Covid – 19, gjatë periudhës raportuese stacioni policor në Rahovec gjatë aktiviteteve policore i ka shqiptuar gjobat si në vijim: 714 gjoba janë shqiptuar duke u bazuar në ligjin për parandalimin dhe luftimin e pandemisë Covid – 19, nga ta 667 për mos bartje të maskës mbrojtëse, 44 për mos respektim të orarit të lëvizjes dhe 3 gjoba për organizimin e ahengjeve apo dasmave.

Sa i përket veprave penale, rastet e iniciuara gjatë kësaj periudhe raportuese gjithsej janë: 156 raste, prej tyre 149 vepra penale dhe 7 tjera incidente të ndryshme. Nga këto raste mundën të iniciohen disa vepra më të rënda: 14 raste vjedhje, 29 raste vjedhje të rënda, 11 raste dhuna në familje, 6 raste armëmbajtje pa leje dhe rrezikimi i trafikut publik me veprim ose mjet të rrezikshëm vetëm 1 rast.

Siguria në komunikacionin rrugor, policia e Kosovës në vazhdimësi ka ndërmarrë masat e nevojshme për ngritjen dhe vetëdijesimin e sigurisë në komunikacion rrugor për të mundësuar lëvizjen e lirë për të gjithë pjesëmarrësit në komunikacion. Stacioni policor në Rahovec është duke implementuar edhe planin operativ Siguria në trafikun rrugor 2021, ku në kuadër të këtij plani gjatë periudhës raportuese nga patrullat policore të stacionit policor në Rahovec janë shqiptuar 1726 kundërvajtje, nga këto 1700 gjoba për kundërvajtje në komunikacionin rrugor dhe 25 kundërvajtje për prishje të rendit dhe qetësisë publike.

Siguria në shkollë, policia e Kosovës në vazhdimësi është duke u kujdesur për sigurinë në shkollë, ku janë duke vazhduar patrullime dhe vizita nëpër shkollë si dhe pika të kontrollit afër shkollave ku është zona e përgjegjësisë. Në fillim të procesit mësimor vazhdojmë me implementimin e planit operativ siguria në shkollë, ku pritet që të ja filloj shkollë me 13 shtator. Është implementuar plani operativ i testit të maturës shtetërore si pjesa e parë ashtu edhe pjesa e dytë, çdo gjë në këtë periudhë ka kaluar mirë, pa ndonjë incident. Sa i përket rasteve në shkollë kemi 3 raste: Një është asgjësimi i pasurisë dhe dy raste të vjedhjeve të rënda në shkollë.

Aktivitetet e tjera të stacionit policor, kemi implementuar projektin bombolat e gazit që vrasin, i cili projekt ka përfunduar në muajin korrik 2021, ku janë inspektuar disa pompa të derivateve që merren me shitjen e gazit si dhe disa biznese të cilat i përdorin bombolat e gazit. Është në implementim e sipër projekti ndërgjegjësimi ndaj dëmtimeve të pronës publike, ku në kuadër të këtij projekti janë mbajtur tre takime me grupe punuese të anëtarëve të KLSP-së në sektorin A. Në kuadër të planit operativ ka qenë fillimi i vaksinimit në masë të qytetarëve, ku patrullat tona sipas nevojës janë angazhuar në qendrat e mjekësisë familjare, ku ka qenë qëllimi ruajtja e rendit, qetësisë dhe sigurisë publike, kjo gjithmonë ka ardhur me kërkesë të drejtorisë së shëndetësisë ose nga drejtori i QKMF-së. Poashtu është duke u zbatuar plani operativ pulti, ku gjatë periudhës raportuese patrullat e stacionit policor kanë bërë patrullime të shtuara rreth pulleve fetare, si xhamitë, teqetë, manastiret, kishat ortodokse, varrezat dhe nëpër banime me popullatë të përzier, ku janë realizuar kontakte me përfaqësues fetarë. Gjithashtu është bërë implementimi i projektit për sigurinë në ahengje me moton “Më pak armë më pak tragjedi”, sa i përket inicimit të planit janë iniciuar 3 raste ku janë përdorur armët e zjarrit, ku më pas janë konfiskuar 4 armë të zjarrit. Është realizuar faza e parë e projektit kamerat e sigurisë në qytetin e Rahovecit dhe në disa fshatra, por për fat të keqe disa kamera janë prishur nga disa persona të cilët janë të njohur për ne dhe ndaj tyre është iniciuar kallëzim penal. Këto kamera pastaj janë riparuar, por sa për informatë kemi 8 kamera të ndryshme nëpër lokacione të ndryshme të qytetit që janë jashtë funksionit, ky problem është raportuar tek kompania përgjegjëse, ku është kërkuar

nga ta që të riparohen, por deri më tani ende nuk kemi ndonjë përgjigje konkrete. Të nderuar kjo ishte sa i përket raportit të kësaj periudhe 3 mujore, nëse ka dikush ndonjë pyetje jam këtu për të ju përgjigjur.

Kryetari – Ju faleminderit toger, këto informata janë mjaftë të rëndësishme për ne, nëse ka dikush të shtoj diçka sa i përket kësaj pika fjala është e juaja.

Shqip Shala – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit në sallë, shqetësimin të cilin do e shpreh sot është një temë krejt tjetër, tani jeni në dijeni që kanë filluar të mbahen ndeshjet e futbollit, por qysh në ndeshjen e parë që luajti klubi jonë i futbollit, ku ishin të pranishëm rreth 1000 shikues dhe gjithçka ishte duke shkuar në rregull, por, përsëri janë duke u shfaqur disa 4-5 recidivistë të cilët e prishin lojën dhe imazhin e Rahovecit. Këta persona janë njihen edhe nga ju toger, unë i kam paralajmëruar ata se një herë keni qenë në polici por nëse veproni kështu përsëri dhe shkoni prapë në polici do jetë shumë më keq për ju, më kanë dhënë fjalën që nuk do të bëjnë më asnjë veprim që do ta prishë lojën, por nëse jo kishte me qenë mirë që të ndërmerret ndonjë masë ndaj tyre.

Bekim Vuçitërna – Sa i përket personave të cilat sipas z.Shala qenkan recidivistë, kryesia e klubit ka të drejtën që t'i identifikoj këta persona dhe t'i shpallin persona "Non Grata", pastaj këta persona nuk do të jenë më shikues të ndeshjeve, këta persona do të ndalohen si nga sigurimi i klubit ashtu edhe nga policia.

Kryetari – Ne shumë shpesh kemi rastet kur shkon personi në polici pse e ka dëmtuar pronën publike, e ka thyer shtyllën e ndriçimit publik, por, nuk e paguan dënimin, e kuptoj që ne duhet të mbajmë një baraspeshe, por kur vjen puna të ligji nuk duhet të ketë kompromise sidomos kur bëhet me vetëdije të plotë.

Kryetari – **Konkluzion** - Besoj se me një bashkëpunim të mirë me policinë, inspektoratin dhe organet e tjera kompetente të cilat i kanë përgjegjësi fushat të cilat i diskutuam më parë, besoj se qetësia publike, rendi si dhe qëndrueshmëria e të gjitha zhvillimeve do të jetë shumë më e fortë.

Shani Hoti – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit në sallë, sa i përket dukurisë së zjarrvënies si të qëllimshme ashtu edhe të pa qëllimshme, poashtu para se me ardhë në takim e dinë edhe t'i vetë sepse ke marrë pjesë personalisht në shuarjen e zjarreve. Edhe pse ekziston ligji për mbrojtjen nga zjarri 04 L/012, aty janë depozitat ndëshkimore, para se të vija në mbledhje siç e ceka isha në shuarjen e zjarrit ku ishte në rrezik edhe lagja jonë, me këtë rast falënderoj policinë e Kosovës dhe zjarrfikësit. Ajo që desha të di është se a ka pasur ndonjë masë ndëshkimore deri më tani për ata persona që kanë shkaktuar zjarrin edhe pse është problem të identifikohen këta persona se vetë ne si qytetar nuk i paraqesim.

Kryetar – Ne për fat të mirë kemi pasur shumë më pak zjarre në krahasim me komunat fqinje, ekipet tona disa herë i kanë dalë në ndihmë zjarrfikësve në Suharekë, Malishevë dhe Kalimash në Shqipëri, por edhe tek ne kanë ardhur në ndihmë zjarrfikësit e komunave fqinje si shkak i djegies së një banese këtu afër komunës për të cilën shkaqet ende nuk dihen. Rreziku më i madh nga zjarri sipas meje vije nga dy arsyt, e parë ne si qytetar jemi të pakujdesshëm ku hedhim cigaret në vend e pa vend, e dyta është se njerëzit ende mendojnë se duke i djegur hamullore pasurohet toka, por sipas agronomëve kjo vetëm sa e dëmton tokën dhe nga djega e tyre pastaj përhapet zjarri dhe ka shumë problem të lokalizohet sepse nuk janë marrë kurrfarë masa kundër përhapjes së zjarrit. Sa i përket gjobave ne nga djegia e arnishtave mundemi të gjejmë pronarët dhe t'i dënojmë, por ne nuk jemi të sigurtë për këtë sepse ai mundet të thotë se unë nuk e kam bërë edhe pse toka është e imja por ka mundësi ndonjë bari e ka bërë. Por ajo që dua të them ka shumë raste që disa persona mirën nga policia në pyetje, pastaj është punë e policisë që të vërtetojë se personi në fjalë a e ka bërë me vetëdije apo pa vetëdije, për derisa ne nuk kemi fakte me ndonjë foto ose ndonjë emër të raportuar nga ndonjë qytetar nuk kemi se si të i gjobisim.

Kryetari – Ju faleminderit i nderuari komandant për përgjigjet e dhëna, kalojmë në pikën e fundit:

4. Të ndryshme.

A ka dikush të shtojë diçka sa i përket kësaj pike, nëse jo atëherë ju falënderoj për kontributin e dhënë, shihemi në takimet e radhës.

Mbledhja përfundoj në ora 17.10

Procesmbajtësi
Agim Hoti

Kryetari i Komunës

Snajl Latifi

